



Delja e Humbur

Një bari i mirë kishte
100 dele. Njëra humbi.



Ai i la 99 të tjerat për të
kërkuar delen e humbur.



Ai u lumturua kur
e gjeti delen. E mori
mbi supet e Tij, plot
gaz deri në shtëpi.

Ai i thirri miqtë dhe
faqinjët e tij të vinin.
“Gëzohuni bashkë me
mua”, – tha ai “sepse
e gjeta delen time që
më kishte humbur”
(Lluka 15:6).



ÇFARË DO TË THOTË KJO?

Ata që mëkatojnë, janë si delja e humbur. Shpëtimtari dha mësim se ka gëzim në qiell kur një mëkatar pendohet (shih te Lluka 15:7).

Kush Është Bariu Ynë i Mirë?

“Bariu ynë i Mirë është i pandryshueshëm dhe ndihet sot rreth mëkatiit dhe mëkatarëve në të njëjtën mënyrë siç u ndje kur eci në tokë. . . . Ai na do kaq shumë, sa na siguroi mënyrën që të pendohemi dhe bëhemi të pastër, që të mund të kthehemi tek Ai dhe Ati ynë Qiellor. . . .

. . . Unë dëshmoj se Jezu Krishti është Bariu ynë i Mirë, i cili na do dhe kujdeset për ne. Ai na njeh dhe e dha jetën e Tij për delet e Tij.”

Plaku Dejll G. Renland, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, konferenca e përgjithshme e prillit 2017 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2017, f. 32).